

VENDIM
Nr. 81, datë 9.2.2022

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

(Ndryshuar me vendimin nr. 518, datë 29.7.2022)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Misioni i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme është hartimi dhe zbatimi i politikave të jashtme, *drejtimi politik i procesit të integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe zhvillimi i dialogut politik me institucionet e Bashkimit Evropian*, zhvillimi dhe fuqizimi i diplomacisë ekonomike, si dhe mbrojtja e të drejtave të shtetasve shqiptarë dhe komuniteteve shqiptare jashtë vendit.

3. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) Harton, përpunon, organizon dhe zbaton politikën e jashtme të shtetit shqiptar;

b) Realizon shprehjen dhe mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar dhe të shqiptarëve në marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare;

c) Mbështet Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Këshillin e Ministrave dhe Presidentin e Republikës së Shqipërisë në përcaktimin e qëndrimeve të rëndësishme lidhur me politikën e jashtme;

ç) Mbron të drejtat e shtetasve shqiptarë dhe të komuniteteve shqiptare jashtë vendit, si dhe organizon, harton e zbaton politikën shtetërore në interes të tyre në bashkëpunimin me ministrinë përgjegjëse;

d) Nxit dhe ndihmon për zhvillimin e komunikimit e të ndërveprimit të diasporës dhe të shqiptarëve jashtë kufijve me përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Shqipërisë, në shtetet ku ata banojnë;

dh) Promovon dhe ndihmon në rritjen e zhvillimin e vlerave dhe të traditave më të mira shqiptare të bashkëkombësit jashtë kufijve shtetërorë;

e) Promovon interesin ekonomik kombëtar në arenën ndërkombëtare, duke ndërmarrë aktivitete zyrtare diplomatike të fokusuara në rritjen e eksporteve, tërheqjen e investimeve të huaja dhe pjesëmarrjen në punë të organizatave ekonomike ndërkombëtare;

ë) *Drejton, bashkërendon dhe shpreh qëndrimet politike në emër të shtetit shqiptar për procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, përfshirë nëpërmjet rrjetit të përfaqësive diplomatike pranë Bashkimit Evropian dhe në vendet anëtare të tij. Zhvillon dialogun politik, përfshirë lidhur me politikën e përbashkët të jashtme e të sigurisë, me institucionet e Bashkimit Evropian dhe vendet anëtare, në kuadrin e procesit të negociatave të aderimit dhe të procesit të stabilizimit dhe të asociimit.*

4. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 500, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”, dhe nr. 510, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Diasporën”, shfuqizohen.

5. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama